

Parimi i sovranitetit shtetëror dhe e drejta për vetëvendosje: Çështja e Kosovës¹

*Uroš Lipušček**

Përmbledhje

Sovraniteti dhe vetëvendosja janë dy norma bazë të së drejtës ndërkombëtare, të cilat shpeshherë bien në kundërshtim me vetveten. Debat i kryesor këtu është se cili parim e kufizon tjetrin dhe përgjigja varet nga vlerësimi i secilit rast. Çështja e Kosovës është një shembull klasik i kësaj dileme. Që të dyja palët, shqiptarët kosovarë dhe serbët, insistojnë në të drejtat e tyre. Duke u bazuar, kryesisht, në arsyen historike, të parët kërkojnë të drejtën e vetëvendosjes në formë të shtetit, ndërsa këta të fundit të drejtën ta mbajnë provincën e Kosovës në kornizën e Serbisë. Arsyet historike, ose të drejtat historike, janë një koncept i vjetruar. Koncepti modern i vetëvendosjes, i zhvilluar nga teoria demokratike e Woodrow Wilson-it, ua mundëson shqiptarëve kosovarë të drejtën për vetëvendosje. Sovraniteti shtetëror nuk është më një koncept absolut përderisa ka lidhje drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave të njeriut. Edhe pse vetëvendosja nuk mund të jetë në pajtueshmëri me të drejtën ndërkombëtare, shqiptarët kosovarë e kanë të drejtën e vetëvendosjes dhe të shtetit të tyre përderisa kanë qenë të shtypur nga regjimi i Milosheviqit. Vetëvendosja vazhdon të jetë një koncept radikal i kësaj kohe dhe aplikimi i saj varet nga rasti në rast duke marrë parasysh faktorë të ndryshëm.

Fjalët kyç: Sovraniteti i brendshëm dhe i jashtëm, vetëvendosje - e brendshme (autonomi) - dhe e jashtme (e drejta për ndarje),

* Uroš Lipušček, PhD, Rektor i Universitetit AAB, Prishtinë, Republika e Kosovës, uros.lipuscek@universitetiaab.com

¹ Ky raport u prezantua nga autori në Konferencën e Parë Ndërkombëtare për Paqe dhe Demokraci: *Perceptimet evropiane, perspektivat evropiane*, Departamenti i Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Koper (Universiteti Primorska, Slloveni), Departamenti i Politikës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Shkolla e Shkencave Humane (Universiteti Swansea, Britani e Madhe), Seminari për Filozofi, Fakulteti Filozofik (Universiteti Martin Luther, Halle-Wittenberg, Gjermani) 4-6, 2008.

ligji i natyrës, të drejtat themelore të njeriut, demokraci, Woodrow Wilson, Pakti i Londrës, Konferenca e Paqes në Paris më 1919, Kushtetuta Jugosllave e vitit 1974.

Parathënie

Nuk është hera e parë që jemi viktimë e një konflikti mbi parimin e sovranitetit të shteteve, i cili është njëri ndër parimet më të larta të së drejtës ndërkombëtare ashtu siç është edhe e drejta për vetëvendosje e cila e përfshin të drejtën për ndarje. Rasti i Kosovës, e cila u shpall e pavarur me 17 shkurt 2008, është një shembull klasik i kësaj dileme në të cilën ka qenë njerëzimi, praktikisht gjatë tërë shekullit XX. Gjatë kësaj periudhe sovraniteti u përhap në tërë botën me përmasa të papara dhe në të njëjtën kohë e drejta për vetëvendosje kufizoi konceptin e sovranitetit suprem të shteteve.

Në Konferencën e Paqes në Versajë, më 1919, sovraniteti u konsiderua si një privilegj i civilizimit (për të "kultivuar dhe edukuar" kryesisht kombet joevropiane). Nën udhëheqjen e gjeneralit Smuts, nga Afrika jugore, katër shtetet më të mëdha (SHBA, Britania e Madhe, Franca dhe Italia), të cilat diktuan ngjarjet në Versajë, miratuan të ashtuquajturin sistem i mandateve për shtetet e pazhvilluara dhe (sipas atyre) të pa kultivuara, jashtë Evropës. Ky sistem mori fund me procesin e shkolonizimit në vitet 1960 kur Asambleja e Përgjithshme e KB-së proklamoi të drejtën e tyre për vetëvendosje.

Më shumë se njëqind shtete lindën në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore dhe rënies së murit të Berlinit, më 1989, si dhe më shumë se njëzet të tjera pas kolapsit të Bashkimit Sovjetik dhe shpërbërjes së ish- Jugosllavisë. Doktrina e vetëvendosjes, e cila kufizoi parimin e sovranitetit, i solli botës shumë dilema të pazgjidhura, domethënë pyetjen se cili parim e frenon sovranitetin suprem të shtetit ose të drejtën për vetëvendosje; kjo dilemë u theksua kryesisht pas përfundimit të luftës së ftohtë. Shumë kombe, të cilat kanë qenë viktimë të balancimit strategjik ndërmjet Fuqive të Mëdha dhe tiranisë ideologjike, filluan të luftojnë për vetëvendosje dhe për të drejtën e ndërtimit të shtetit të tyre pas rënies së perdes së hekurt dhe

pas ndryshimit të baraspeshës së fuqive. Ky proces ka qenë kundërthënës. Në njërën anë, vetëvendosje do të thoshte shkëputje e një shteti dhe, në anën tjetër, krijim i një shteti të ri. Ballkani i cili, sipas deklaratës së Winston Churchill, ka prodhuar më shumë histori sesa ka mundur të kapërdijë, është një shembull i përsosur për këtë problem; çështja e Kosovës është dëshmia më e mirë për këtë.

I. Argumentet kryesore historike

Për të kuptuar këtë problem, ne duhet t'i analizojmë rrënjët e kësaj krize. Fillimisht nga pikëpamja historike, serbët, nga njëra anë, insistojnë që Kosova dhe Metohija ishte dikur pjesë e Perandorisë Serbe. Nga ana tjetër, historianët shqiptarë theksojnë faktin që shqiptarët nuk ishin vetëm ardhësit e parë në këtë pjesë të botës (ata e konsiderojnë vetën si pasardhës të Ilirëve) por që Shqipëria kishte gjithashtu principatat e veta autonome gjatë Mesjetës.

Në fillim të shekullit XX, kur u bë e ditur se Perandoria Osmane nuk do të mund të mbijetonte, shqiptarët të cilët jetonin në katër vilajete të Perandorisë luftuan për bashkimin e shqiptarëve në një vilajet apo njësi politike. Në mënyrë të ngjashme, për shembull, edhe sllovenët, në pjesët perëndimore të Ballkanit, kanë kërkuar që nga viti 1848 "Zedinjena Slovenija" (Shteti bashkuar slloven), autonomi nën sistemin e Perandorisë së Habsburgëve.

Shqiptarët të cilët jetuan jashtë Perandorisë Osmane kanë luftuar për bashkimin e tyre që nga miratimi i programit të Lidhjes së Prizrenit në vitin 1878. Ambiciet e fuqive të mëdha në fillim të shekullit të kaluar nuk kanë qenë në favor të bashkimit të shqiptarëve. I njëjti rast ndodhi edhe tek serbët të cilët nuk kishin sukses në realizimin e ambicieve të tyre për t'u unifikuar me fiset e tyre që jetonin nën kornizat e Perandorisë së Habsburgëve dhe asaj Osmane pas fitoreve në luftërat e Ballkanit, veçanërisht me serbët e Bosnjës dhe Hercegovinës, e cila u përvetësua nga Austria në vitin 1908. Në vitin 1912, shqiptarët kërkuan nga Fuqitë e Mëdha të kohës të ishin një shtet i pavarur. Perandoria Ruse më së shumti ishte kundër

bashkimit të shqiptarëve, për arsye se kjo do ta dobësonte shtetin serb dhe ambiciet e saj për të pasur dalje të lirë në det nëpërmjet Shqipërisë. Nga ana tjetër, austro-hungarezët u munduan të parandalonin rritjen e ndikimit rus mbi Ballkanin. Rezultati i kësaj gare strategjike ndërmjet Fuqive të Mëdha, ishte shpallja e shtetit të Shqipërisë në Nëntor 1912. Kufijtë shqiptarë që u vendosën në atë kohë, janë pothuajse identikë me ata të sotmit.

Historiani i mirënjohur serb i asaj kohe, Jovan Cvijic, insistonte që “Serbia ka të drejtat e saj historike të okupojë Shqipërinë dhe disa pjesë të Greqisë, pasi që këto kishin qenë të okupuara nga Car Dushani në kohën e Mesjetës dhe ishin në kornizat e Serbisë. Për shkak të pavarësisë ekonomike, Serbia duhet të kishte dalje në Detin Adriatik përmes një pjese të bregdetit shqiptar, ose duke okupuar këtë territor, ose duke fituar të drejtën e veprimit ekonomik dhe të trafikut në këto rajone”.² Këto kërkesa u bazuan në programin e “Nacertanijes” i cili u shpall në vitin 1844 dhe më vonë u zbatua posaçërisht nga kryeministri serb Pashiq, i cili kërkoi për Serbinë dalje në Detin Egje nëpër Selanik dhe, në Detin Adriatik, nëpërmes veriut të Shqipërisë.

Kjo çështje ishte pika kryesore e Konferencës së Ambasadorëve të gjashtë shteteve (Austro-Hungaria, Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Rusia) në Londër, ku u diskutua mbi një zgjidhje për çështjen shqiptare. Pas bisedave të gjata private, në të cilat Italia dhe Austro-Hungaria treguan pak a shumë qëndrim të njëjtë, me ndihmën e Francës dhe të Britanisë së Madhe, Konferenca vendosi që Shqipëria të jetë një shtet i pavarur dhe neutral, ekzistenca e të cilit do të garantohej nga gjashtë Fuqitë e Mëdha. Serbia nuk kishte të drejtë daljeje në det përmes Shqipërisë. Austro-Hungaria insistonte që shteti i ri t’i përfshinte të gjitha vendet e banuara nga shqiptarët por kjo u kundërshtua nga Franca dhe posaçërisht nga aleati serb, Rusia.³ Për t’i plotësuar interesat e serbëve, malazezëve dhe grekëve, sipas Paktit të Londrës në

² Ali Jakupi, *Dy shtete shqiptare dhe bashkimi kombëtar*, MMEI, Prishtina, 2004, p.116-117.

³ Noel Malcolm, *Kosova – një histori e shkurtër*, Pan Books London, 2002, p.256.

1913, Serbisë iu dha Kosova, Malit të Zi Peja dhe Gjakova, ndërsa Greqisë Janina dhe Epiri. Për pasojë, shumica e shqiptarëve duhej të jetonin jashtë kufijve të shtetit të pavarur të Shqipërisë.⁴

Synimi strategjik i Serbisë ishte, përveç dobësimit të Perandorisë Osmane, të kishte dalje në Detin Adriatik. Për këtë arsye, ushtria serbe pushtoi portin e Durrësit dhe kreu krime aq të rënda, sa që edhe raportuesi në atë kohë (lideri i ardhshëm revolucionar rus) Leon Trotsky, i cili raportonte nga Ballkani, i përshkroi ato si të tmerrshme. Gjithashtu kritik ndaj politikës “ekspansioniste dhe koloniale” të qeverisë serbe, ka qenë dhe lideri i partisë socialdemokrate të Serbisë, Dimitrije Tucovic. Oficeri i ri serb, Dragisa Vasic, i cili mori pjesë në ofensivën e ushtrisë serbe në veri të Shqipërisë, shënoi në memoaret e tij që “Shqipëria e pafat do të mbetë për një kohë të gjatë varr i mbuluar me turpin tonë”.

Pas nënshkrimit së marrëveshjes, në Gusht 1913, ministri britanik i punëve të jashtme, Sir Edward Grey, pohoi: “Jam shumë i sigurt që kur do të bëhet gjithçka e njohur, kjo zgjidhje do të jetë shkak për shumë kritika nga njerëzit të cilët e njohin atë vend dhe e gjykojnë situatën nga këndvështrimi lokal. Një gjë nuk duhet harruar që, duke u munduar për të gjetur një zgjidhje, qëllimi ishte të arrijmë një marrëveshje mes Fuqive të Mëdha dhe të krijojmë paqe në Evropë”.⁵ Megjithatë, më 4 Gusht, vetëm një vit më vonë, filloi Lufta e Parë Botërore.

Diplomacia e Habsburgëve luajti rolin kryesor në përpjekjet për ta ndaluar daljen e Serbisë në det përmes Shqipërisë. Qëllimi i Austro-Hungarisë ishte që, në këtë mënyrë, ta dobësonte Serbinë ekonomikisht dhe ta rregullonte rrugën e vet për aneksime të mundshme më vonë, zgjidhje për të cilën menduan, në Vjenë, që do ta “zgjidhte” çështjen sllavo-jugore në favor të tyre. Duke penguar Serbinë, Italia dëshironte gjithashtu të ndalonte daljen e Ruisë në Detin Adriatik dhe, duke përkrahur Shqipërinë e pavarur, qeveria italiane mendonte që një pjesë e Shqipërisë do të mbetë në interesat e

⁴ Hajredin Kuçi, *Pavarësia e Kosovës*, Jalifat Group, Houston, 2005, p.26.

⁵ Ibid. p. 27

saj. Ky qëllim u aktualizua në Prill 1915, kur Italia si dhe fuqitë tjera nënshkruan Paktin e Londrës. Nga ana tjetër, Britania e Madhe dëshironte ta ndalonte Austro-Hungarinë nga marrja e kontrollit mbi Selanikun, përmes të cilit do të mund t'i kontrollonte të gjitha daljet në det dhe ta ndalonte rikthimin e Perandorisë Osmane.

Të njëjtat shtete të cilat votuan për pavarësinë e Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në korrik 1913, nënshkruan një marrëveshje sekrete (vetëm 22 muaj më vonë, saktësisht me 22 prill 1915), e cila u bë historikisht e njohur si Marrëveshja e Londrës, marrëveshje kjo e cila vulosi fatin e Shqipërisë për shumë vjet. Për të shuar etjen imperialiste, kryesisht të Italisë, ata ndanë Shqipërinë fshehurazi dhe iu dhanë disa pjesë të banuara nga shqiptarët, ndër të tjerë, Serbisë dhe Greqisë.

Madje edhe ministri britanik i punëve të jashtme, Balfour, pasardhësi i Sir Edëard Grey, i cili ishte autori kryesor i kësaj marrëveshjeje, pohonte gjatë vizitës së tij në Uashington në vitin 1917⁶ që “në emër të urgjencës strategjike është bërë një krim i rëndë kundër parimit të shtetësisë”. Pakti i Londrës u bë një çështje klasike historike e politikës së Fuqive të Mëdha mbi varësinë e shteteve dhe popujve të vegjël në emër të domosdoshmërisë strategjike.

Edhe pas Luftës së Parë Botërore, në Konferencën e Paqes në Versajë, shqiptarët ishin prapë viktimë, pavarësisht nga e drejta për vetëvendosje e shpallur nga presidenti amerikan Woodrow Wilson. E drejta tyre për unifikimin e plotë është mohuar sërish, për t'i kompensuar aleatet e tyre italian dhe serb, në një mënyrë dhe Greqinë (për pjesëmarrjen e tyre në përkrahjen e aleatëve dhe për sakrificat gjatë të ashtuquajturës Luftë të Madhe).

Fati i Shqipërisë u komplikua edhe për arsye se amerikanët me ndikimin më të madh në Konferencën e Paqes, nuk patën qëndrim të unifikuar një kohë të gjatë lidhur me këtë çështje. Në njërin nga raportet e tyre, ekspertët amerikanë madje dhe kundërshtuan ekzistencën e Shqipërisë si shtet i pavarur, duke

⁶ Uroš Lipušček, *Ave Wilson, ZDA in Prekranje Slovenije v Versaillesu 1919-1920*, Založba Sophia Ljubljana, 2003, p.60.

propozuar ndarjen e saj. "Territori verior me Shkodër duhej t'i takonte Malit të Zi; territori i mesëm, duke përfshirë dhe Durrësin, Serbisë dhe pjesa jugore me Vlorën, Greqisë. Autori i këtij projekti i justifikoi ndarjet, duke pohuar se shqiptarët janë një popull i zhurmshëm dhe malor që ka mungesë të organizimit jetësor social".⁷

Më në fund, presidenti Wilson refuzoi, në Konferencën e Parisit, ndarjen e Shqipërisë e cila ishte përcaktuar në Paktin sekret të Londrës me 1915, por, në anën tjetër, refuzoi gjithashtu kërkesat e Shqipërisë për të pasur një mandat amerikan mbi Shqipërinë (Armenët kishin shprehur dëshira të ngjashme). Ai gjithashtu refuzoi idenë që Serbia apo Greqia të qeveriste në Shqipëri meqë të dyja palët kishin interesat e tyre në rajon. Britania e Madhe dhe Franca nuk ishin të interesuara për atë rol, prandaj i vetmi shtet me apetitin më të madh për Shqipërinë mbeti Italia dhe Wilson zgjodhi atë për të qeverisur shtetin. Ai dukshëm dëshironte t'i ndalte kërkesat e Italisë mbi rajone të tjera të Adriatikut, posaçërisht ato drejt Rjekës dhe Dalmacisë.

Në Prill 1919, Wilson rekomandoi që Italia të kishte kontroll mbi Vlorën. Një zgjidhje e tillë u parashikua edhe nga koloneli sekret i tij House në një letër dërguar atij në tetor 1918.⁸ Kur ajo letër me këtë propozim u zbulua nga anëtarët e delegacionit shqiptar, ata i dërguan një letër Wilsonit, në të cilën pohuan se "propozimi i tij bie në kundërshtim me parimet e shtetësisë dhe të drejtën e secilit popull për vetëvendosje. Nëse Italisë i takon Vlora për arsye të veçanta, atëherë edhe për Greqinë dhe Serbinë do të jetë e mundur t'i marrin jo vetëm territoret e okupuara, por të kërkojnë edhe më tepër, si Greqia Korçën dhe Serbia Shkodrën".⁹ Për të ndaluar Italinë nga okupimi i Shqipërisë, Serbia rekomandoi që Shqipëria të mbetej e pavarur brenda kufijve të vitit 1913. Mirëpo, presidenti amerikan i kohës insistoi me kokëfortësi në propozimin e tij të parë.¹⁰

⁷ Haris Silajdžić, *Albanija i SAD kroz arhive Wašingtona*, Oslobodjenje, Sarajevo, 1991, p.71.

⁸ Owen Pearson, *Shqipëria dhe mbreti Zog*, Qendra për studime shqiptare, London, 2004, p.114.

⁹ Haris Silajdžić, vep. cit. p.127-128.

¹⁰ Politikanët sllovenë që, në pajtim me Paktin e Londrës, i kërkuan Wilsonit në

Wilson ndërroi përfundimisht qëndrimin e tij dhe ndaloi ndarjen e mëtejme të Shqipërisë kur më 24 shkurt 1920 refuzoi propozimet e bëra, pa dijen e tij, nga Britania e Madhe dhe Franca më 14 janar 1920,¹¹ duke argumentuar se qeveria amerikane po i kundërshtonte ashpër padrejtësitë e bëra në Shqipëri nga Jugosllavia dhe, nga ana tjetër, po i toleronte ato të ngjashme, të bëra nga Italia kundër Jugosllavisë ¹². Në një njoftim diplomatik në Konferencën e Paqes në Paris në mars, zyrtarët e lartë të shtetit deklaruan se “as presidenti, por as populli amerikan kurrë nuk do të miratonin që populli shqiptar, i cili ka luftuar dymijë vjet për lirinë e tij, të sakrifikohej për ambiciet politike të fqinjëve të tyre”.¹³

Ende nuk dihet se si dhe nën ndikimin e kujt ai shpalosi një qëndrim pozitiv pro-shqiptar. Në janar 1918, Wilson u deklarua që ai nuk i kishte marrë aspak parasysh interesat e popullit shqiptar në programin e tij për paqe. Nën pikën njëmbëdhjetë, ai e injoroi tërësisht ekzistencën e pavarësisë së Shqipërisë, duke kërkuar, në anën tjetër, largimin e Rumanisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Mirëpo, në një formë të paqartë u përfshinë edhe interesat e Shqipërisë në atë formulim që lidhjet e disa shteteve ballkanike duhej të përcaktoheshin përmes një këshilli miqësor bazuar në besnikëri dhe shtetësi. Sidoqoftë, propozimi i Wilson-it që Italia të merrte mandatin mbi Shqipërinë dhe sovranitetin mbi portin e Vlorës, mbetet fakt historik. “Ky propozim nuk përputhej me parimin e së drejtës për vetëvendosje, të cilën e mbronte ai në fund të luftës. Atëbotë, Wilson-i ishte ai që propozoi mandatin italian dhe okupimin e Vlorës pa miratimin

Konferencën e Paqes në Paris, referendum apo plebishit popullor në territoret e okupuara nga ushtria italiane, në rajonin Primorska, por u refuzuan, kaluan po aq keq. Po ashtu, kur delegacioni sloven në Mbledhjen e Parisit në qershor 1919 lutën Wilsonin që të mos lejonte një plebishit në Carinthia, sepse slovenët do të humbnin për shkak të politikave asimiluese austriake, Wilsoni qëndroi plotësisht imun ndaj kërkesave të tyre.

¹¹Kryeministrat e Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë (në mungesë të delegatit amerikan Frank Polk) u propozuan delegatëve jugosllavë që Italia të mbante Vlorën, siç thuhej në Paktin e Londrës, që kufijtë veriorë të Shqipërisë do të rirregulloheshin; që qarku shqiptar që do të përfshinte Shkodrën dhe Shëngjini do të administroheshin nga Serbia.

¹² Pearson, *Ibid* p.141.

¹³ *Ibid*, p. 142.

dhe kundër dëshirës së popullit shqiptar. Me sa duket, ai e pranoi padrejtësinë e madhe ndaj popullit shqiptar dhe parandaloi ndarjen radikale të territorit shqiptar ndërmjet fqinjëve. Veprimet e tij në Konferencën e Paqes në Paris vlerësohen edhe sot si kundërthënëse.¹⁴

Gjatë Mbretërisë së Jugosllavisë, e cila lindi pas Luftës së Parë Botërore, shqiptarët ishin viktima të tiranisë dhe kolonializmit. Kjo politikë u përkrah nga Vasa Cubrilovic (i cili ishte pjesëtar i një komploti për vrasjen e trashëgimtarit mbretëror austriak Franc Ferdinand). Në fjalimin e tij të famshëm në “klubin kulturor” në vitin 1937, ai propozoi dëbimin e krejt shqiptarëve “me kulturë turke”. Vetëm për shkak të fillimit të Luftës së Dytë Botërore, marrëveshja e nënshkruar me 1938 ndërmjet Mbretërisë Jugosllave dhe Turqisë mbi emigrimin e mijëra shqiptarëve në Turqi (për arsye se ata ishin myslimanë, ata u konsideruan si turq), nuk ka mundur të ekzekutohej tërësisht.

Gjithashtu edhe shqiptarëve të Kosovës iu mor e drejta e vetëvendosjes nga udhëheqja komuniste serbe në vitin 1945 me anulimin e të ashtuquajturës Deklarata e Bujanit, që u miratua në vitin 1944, në të cilën Partia Komuniste e Jugosllavisë kishte pranuar të drejtën e vetëvendosje për shqiptarët kosovarë dhe bashkimin e tyre.

Edhe pas luftës, Qeveria e Re Socialiste e Jugosllavisë nuk e ndaloi politikën e dëbimit të shqiptarëve në Turqi. Në bazë të Marrëveshjes së Splitit ndërmjet Jugosllavisë dhe Turqisë në vitin 1952, disa qindra- mijëra shqiptarë kosovarë (sërish) emigruan në Turqi. Edhe ky plan nuk u ekzekutua tërësisht pasi që autori kryesor i tij, ministri i punëve të brendshme, Aleksandër Rankovic, u largua nga pushteti në vitin 1966. Sidoqoftë, valët e emigrimit të shqiptarëve nga Kosova vazhduan deri në shpërbërjen e Jugosllavisë.¹⁵

¹⁴ Urosh Lipuscek, “Çështja Kombëtare Sllovene dhe Shqiptare në kuadrin e Luftës së Parë Botërore - ngjashmëri dhe dallime”, in *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e Shtetit Shqiptar gjatë shek. XX*, Instituti Historisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2008, p.238.

¹⁵ Historianët serbë ende argumentojnë se shqiptarët kanë okupuar territorin i cili ishte i banuar nga rreth 300.000 serbë, të cilët u larguan nga Kosova që t’i shmangeshin masakrave turke pas dështimit të forcave serbe dhe austriake për të larguar armatën turke nga Kosova. Ata theksojnë, po ashtu, se serbëve, që janë larguar nga

Që të dyja palët kundërshtuese insistojnë në të drejtat e tyre historike, posaçërisht serbët të cilët nuk mund të harrojnë që Kosova ishte vendi ku në vitin 1389, pas betejës epike në Fushë Kosovë, Serbët humbën pavarësinë e tyre dhe ishin për shekuj të tërë vetëm një vilajet i parëndësishëm i Perandorisë Turke. Kërkesat e serbëve bazohen në të drejta historike dhe traditën e Serbisë në mesjetë. (Istorijsko pravo zasnovano na tradiciji srpske srednjevekovne države). Ky koncept i vjetër u shua gjatë Luftës së Parë Botërore me shpërbërjen e perandorive të vjetra. Perandoria Austro-Hungareze është një shembull i përsosur për argumentet e bazuara në të drejtën historike.

Çekët, polakët dhe kroatët, për shembull, kërkuan shtetet e tyre në kornizat e Perandorisë së Habsburgëve, duke u bazuar në të drejtat e tyre historike pasi që të gjithë ata kishin mbretëritë e tyre të pavarura në të kaluarën.¹⁶ Ky koncept kaloi në histori me rastin e shpalljes së doktrinës së vetëvendosjes në fund të Luftës së Parë Botërore, e cila u iniciua nga lideri rus socialist- revolucionar Vladimir Iljic Lenin dhe u zhvillua më vonë nga presidenti amerikan Woodrow Wilson.

II. Argumentet kryesore ligjore

Koncepti i Leninit mbi vetëvendosjen u dha të drejtën për vetëvendosje të gjithë popujve të kolonizuar. Duke zgjeruar këtë koncept, e drejta për vetëvendosje u bë një koncept global. Nga ana tjetër, presidenti amerikan Woodrow Wilson zhvilloi, posaçërisht pas Luftës së Parë Botërore, konceptin e vetëvendosjes duke u fokusuar kryesisht në Evropë në zgjidhjen e problemeve të Perandorive të Habsburgëve dhe asaj Osmane. Ai bëri një lidhje të drejtpërdrejtë mes demokracisë dhe parimit të vetëvendosjes, ndërsa Lenini u fokusua më shumë në vetëvendosjen e popujve të ashtuquajtur kolonialë.¹⁷

Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore, u është ndaluar nga autoritet komuniste që pas luftës të ktheheshin në Kosovë.

¹⁶ Sillovenët që nuk e kishin këtë traditë, bazuan kërkesat e tyre në “Zedinjena Slovenia” (Slllovenia e Bashkuar), si p.sh. në të drejtën e ligjit natyror dhe më vonë në të drejtën për vetëvendosje të proklamuar nga presidenti Wilson.

¹⁷ Parimet e Leninit mbi vetëvendosjen vlenin në praktikë vetëm për kombet: vetëm

Parimi i tij është në thelb një koncept i zhvilluar nga Rousseau dhe është i njohur si *volonté générale* (dëshira e përgjithshme apo thjesht dëshira e popullit). Me fjalë të tjera, secili njeri, pavarësisht nga vendi gjeografik, ka të drejtë të jetojë në demokraci. Sipas doktrinës së Wilsonit të zhvilluar pas Luftës së Dytë Botërore me themelimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, minoritetet dhe nacionalitetet, të cilët jetojnë në demokraci, kanë vetëm të drejtën për vetëqeverisje me përjashtim të së drejtës për shkëputje. Sipas mësimëve të vjetra të Thomas Aquin-it, grupet e shtypura zhvilluan të drejtën për çlirimin e tyre nga diktaturat (në pajtim me *ligjin e natyrës*). Mësimet e tij morale, teologjike janë përfshirë edhe nga Wilson në përcaktimin e tij të vetëvendosjes. Sipas tij, njerëzit të cilët jetojnë nën diktaturë, kanë të drejtë të zgjedhin fatin e tyre; ky koncept i zhvilluar gjatë Luftës së Parë Botërore, është, domethënë, e drejta për vetëvendosje të jashtme. E drejta për vetëqeverisje është e njohur si vetëvendosje e brendshme, ndërsa e drejta për shkëputje u bë e njohur si vetëvendosje e jashtme.

Koncepti modern i vetëvendosjes, i përpiluar pas vitit 1960 kur asambleja e përgjithshme e KB-së nxori të drejtën për vetëvendosje për të gjithë popujt kolonialë, është në lidhje të drejtpërdrejtë me demokracinë dhe, posaçërisht, me konceptin e të drejtave themelore të njeriut. Duhet theksuar që, gjatë viteve të fundit, asnjë dokument i rëndësishëm ndërkombëtar nuk është përpiluar në lidhje me të drejtën e vetëvendosjes. Një shembull konkret është Marrëveshja Përfundimtare e Helsinkit mbi paqen dhe sigurinë evropiane, e cila parasheh që kufijtë në Evropë mund të ndryshohen vetëm me pëlqimin e të gjitha shteteve përkatëse. Deklaratat e bëra nga Kombet e Bashkuara insistojnë, kryesisht, në integritetin territorial të shteteve. Ashtu

kombet e tëra kanë të drejtën e vetëvendosjes. Koncepti i zhvilluar nga Wilson-i, i cili lidhet me parimet e demokracisë, lejon edhe vetëvendosjen e një pjese të kombit; p. sh., potencialisht minoritetet e shtypura brenda një shteti kane të drejtën e vetëvendosjes. Në rastin e Kosovës, koncepti i Leninit nuk do t'i lejonte një pjese të kombit shqiptar, që jetonte në Serbi, të drejtën për vetëvendosje, pasi që shqiptarët tashmë kishin një shtet të tyre. Koncepti i zhvilluar nga Woodrow Wilson në anën tjetër, do t'u lejonte të drejtën për vetëvendosje për shkak të shtypjes së tyre të vazhdueshme dhe shfuqizimit të autonomisë së tyre gjatë regjimit të Milosheviqit.

siç është, për shembull, çështja e vetëvendosjes, edhe koncepti i sovranitetit ka dy anë: ato të jashtme dhe ato të brendshme. Dimensioni i jashtëm i sovranitetit është relativisht lehtë për t'u matur; meqë ky është koncept i "sistemit të së drejtës ndërkombëtare", do të thotë që një shtet vepron si një entitet i njohur ndërkombëtarisht, pa iu nënshtruar formalisht ndonjë shteti të huaj. Sovraniteti i brendshëm është një fenomen më kompleks. Në thelb, ky përshkruan ekzistencën e vetëm një autoriteti suprem shtetëror brenda kufijve të një shteti. Hapësira dhe kufijtë e sovranitetit janë shumë më të paqarta. Ky proces filloi me miratimin e të ashtuquajturës Marrëveshjes për Minoritete në Konferencën e Paqes në Versajë më 1919, e cila kufizoi pushtetin e disa shteteve, dhe më vonë u konfirmua, me rastin e themelimit të Ligës së Kombeve dhe, në vitin 1945, me organizimin e Kombeve të Bashkuara, të cilat shpallën Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, më 1948. Koncepti i të drejtave të njeriut është përmirësuar që atëherë dhe është bërë qendër e së drejtës ndërkombëtare si dhe e matjes së demokracisë bile edhe i ligjshmërisë së disa qeverive. Domethënë, sovraniteti absolut nuk ekziston më.¹⁸

Pavarësisht nga ky fakt, e drejta ndërkombëtare ka zhvilluar një koncept i cili garanton më tepër sovranitetin e shteteve sesa të drejtën për vetëvendosje. Fuqizimi i një koncepti për të drejtat e njeriut ndryshoi qëllimin e sovranitetit, i cili konsiderohet të mos jetë më absolut. Kuptimi i përgjithshëm shkaktoi që sovraniteti të jetë kufizuar seriozisht në mbrojtjen e të drejtave themelore të njerëzve të një shteti përkatës. Popujt dhe minoritetet të cilët nuk i gëzojnë të drejtat themelore të njeriut në shtetin ku ata jetojnë apo të cilët janë të shtypur, kanë të drejtën për vetëvendosje të jashtme.

Kjo ishte saktësisht arsyeja të cilën përdorën shqiptarët e Kosovës në mbrojtjen e së drejtës së tyre për vetëvendosje të jashtme dhe së drejtës për pavarësi. Në vitet 1990, regjimi i Milosheviqit ndryshoi statusin të cilin e kishte Kosova në kornizën kushtetuese të ish- Jugosllavisë të miratuar në vitin

¹⁸ Termi sovranitet nënkupton zakonisht autoritetin suprem. Në një këndvështrim klasik të ligjit ndërkombëtar, sovraniteti definohet nga shteti si arbitër suprem.

1974. Regjimi i Milosheviqit shfuqizoi tërësisht kushtetutën, e cila përcaktonte Kosovën si pjesë përbërëse të Federatës Jugosllave, duke qenë vetë përfaqësuese në Parlamentin Federativ. Kosova ishte njësi kushtetuese federative (Neni 1,2 i Kushtetutës Federative) e përfaqësuar në të gjitha organet federative, duke përfshirë këtu edhe presidencën kolektive, parlamentin, ekzekutivin dhe gjyqin federativ (Neni 381). Ajo gëzoi të drejtën e mbrojtjes territoriale dhe pjesëmarrjen në bashkëpunime ndërkombëtare (Neni 277). Ajo kishte buxhetin e vet, i cili miratohej nga Asambleja Federative si dhe institucionet e veta bankare (Neni 250).¹⁹

Jo vetëm që regjimi i Milosheviqit shfuqizoi statusin autonom të Kosovës brenda Federatës Jugosllave, por ai ushtroi edhe sundim të ashpër në Kosovë, që shkaktoi dëbimin e pothuajse gjysmës së popullatës shqiptare-kosovare nga Kosova në vitin 1999. Prandaj, të drejtat themelore të njeriut të shqiptarëve kosovarë atje u diskriminuan në mënyre skandaloze. Kjo gjendje përfundoi me intervenimin direkt të NATO-s, me bombardimet në Serbi edhe pa miratimin e Këshillit të Sigurisë.

Shtetet udhëheqëse perëndimore e justifikuan intervenimin direkt kundër Serbisë me argumentin që koncepti i të drejtave të njeriut është koncept suprem i së drejtës globale dhe që sovraniteti i shteteve është në shërbimin e këtij parimi.

Përndryshe, komuniteti ndërkombëtar nuk mund të tolerojë dhunë skandaloze dhe mospërfillje të të drejtave themelore të njeriut në një vend, edhe nëse kjo bie në kundërshtim me parimin e sovranitetit të shteteve.²⁰ Komuniteti ndërkombëtar

¹⁹ Dr. Islam Lauka, *Kosova: rast universal apo sui generis?*, Instituti shqiptar për studime politike, Instituti i Historisë i Kosovës, Kristalina-KH, Tirana 2007, p. 111.

²⁰ Intervenimi i NATO-s kundër Serbisë pa një miratim eksplicit të Këshillit të Sigurimit i cili, sipas rregullave të KB-së, është organ përgjegjës për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, është kritikuar nga shumë juristë prominentë ndërkombëtarë si një aksion joligjor që mund të cilësohet si agresion. Ata mendonin se një krim nuk mund të luftohet me shkeljen e një norme tjetër dhe, për këtë arsye, kjo do të shkaktojë një krim të ri[...] Sipas mendimit të tyre, të drejtat e njeriut nuk janë më një çështje e brendshme dhe nuk i përkasin ekskluzivisht sistemit të brendshëm juridik të cilitdo shtet. Për këtë më shumë është shkruar në Alain Pellet, *Sovraniteti shtetëror dhe mbrojtja e të drejtave themelore njerëzore, një këndvështrim i ligjit ndërkombëtar*, Puglash Occasional Papers, Shkurt, 2000. www.pugwash.org/reports/re/pellet.htm. accessed 10/20-2008.

veproi, pra, në bazë të konceptit të Woodrow Wilson-it, sipas të cilit secili popull dhe secili person ka të drejtë të jetojë në demokraci dhe pa asnjë tirani.

Për këtë arsye, rasti i Kosovës është shumë i veçantë. Ky rast dallon, për shembull, krejtësisht nga ai në Bosnje dhe Hercegovinë -Republika Serbe, edhe nëse e anashkalojmë faktin që kjo Republikë lindi nga dëbimi masiv i Boshnjakëve nga vendet në Bosnje me shumicë serbe. Ky entitet nuk ka të drejtë shkëputjeje dhe pavarësie përderisa komuniteti serb në Bosnje dhe Hercegovinë jeton në demokraci (sipas një interpretimit të vetëvendosjes nga Wilson).

Politikanët serbë në Beograd e mbrojnë vazhdimisht të drejtën e Serbisë për të ndaluar shkëputjen e Kosovës nga Serbia, duke argumentuar se Serbia është tashmë një vend demokratik i njohur nga komuniteti ndërkombëtar. Ky argument është i pamjaftueshëm. Për shkak të sundimit të rëndë, të cilin regjimi i Milosheviqit i ka shkaktuar Kosovës, komuniteti ndërkombëtar (më saktësisht Këshilli i Sigurimit) i ka dërguar Kosovës një protektorat mbikëqyrës të KB-së. Me Rezolutën 1244 të miratuar në vitin 1999, Këshilli i Sigurimit shfuqizoi de facto sovranitetin serb mbi Kosovën. Kjo ishte gjendja deri në shkurtin e këtij viti kur institucionet provizore të Kosovës shpallën pavarësinë e saj. Mirëpo, edhe pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ende nuk është tërësisht dhe zyrtarisht shtet i pavarur dhe sovran përderisa është nën mbikëqyrjen e komunitetit ndërkombëtar. Kujtimet nga koha e sundimit të rëndë serb janë akoma thellë në mendjet e shqiptarëve nga Kosova. Me këtë sundim gjatë viteve 1990, Serbia ka humbur legjitimitetin për të qeverisur Kosovën në të ardhmen. Asnjë shtet, duke përfshirë këtu edhe Serbinë, nuk mundet ta kthejë statusin e mëparshëm të Kosovës si provincë e Serbisë, përderisa shqiptarët kosovarë nuk duan (në asnjë mënyrë) të pranojnë një gjë të tillë nga autoritetet e Beogradit.

Ky është realitet i cili nuk mund të injorohet. Zgjidhja e vetme për të krijuar paqe në këtë pjesë të Ballkanit dhe stabilitet në rajon, është njohja e të drejtës së shqiptarëve kosovarë për shtetin e pavarur. Kjo është edhe në interesin e Serbisë. Sikur shqiptarët kosovarë të qëndronin vetëm edhe për një gjeneratë në kornizën e Serbisë, pothuajse gjysma e popullatës do të

përbëhej nga shqiptarët për shkak të shtimit të popullatës në Kosovë, e cila është më i larti në Evropë, dhe zvogëlimit të saj në Serbi. Me fjalë të tjera, nëse Kosova do të mbetet pjesë kushtetuese e Serbisë, atëherë Serbia nuk do të ishte më shtet kombëtar serb, por do të bëhej një shtet federal. Në këtë rast, shqiptarët kosovarë do të duhej të kishin një përfaqësim të duhur në Parlamentin Serb dhe institucionet qeverisëse. A janë politikanët serbë të gatshëm për një skenar të tillë? Kohërat kur Kosova ka mundur të shndërrohej në një lloj Bantustani, kanë marrë fund përgjithmonë.

Përfundim

Historia është e mbushur përplot me lindje dhe rënie të shteteve. Serbët mund ta mbajnë shtetin e tyre kombëtar vetëm nëse e pranojnë realitetin e ri; përndryshe, ka mundësi të shndërrohen në minoritet pas disa gjeneratave për shkak të zvogëlimit të popullsisë. Sa i përket të drejtës ndërkombëtare, rasti i Kosovës dëshmon se sovraniteti nuk është më vlerë absolute dhe që ajo nuk mund të keqpërdoret për t'i shkelur të drejtat themelore të njeriut tek minoritetet (të paktën në Evropë) dhe që vetëvendosja, edhe pse nuk është bërë koncept legjitim, mund të zbatohet në të gjitha vendet dhe krizat e mundshme; ky koncept ka ende potencial të madh. Kjo e drejtë nuk është e nënkuptueshme; për të vendoset sipas rastit në rast, varësisht nga gjendja gjeostrategjike dhe aspiratat e personave përkatës në pushtet. Shqiptarët kosovarë, për shembull, fillimisht e kanë shpallur pavarësinë e tyre në Kaçanik në vitin 1999, një fakt i cili nuk u miratua nga komuniteti ndërkombëtarë. Sot, pavarësia e Kosovës është njohur nga më shumë se 50 shtete, gjë që dëshmon se një pjesë e rëndësishme e komunitetit global ia ka miratuar Kosovës sovranitetin e saj të jashtëm.

Minoriteti shqiptaro-kosovar i mëparshëm në Republikën e Serbisë tashmë është shumicë në shtetin e ri të Kosovës dhe serbët janë në minoritet. Pra, është detyrë e shumicës së re për t'i siguruar të drejtat e njeriut në shoqërinë kosovare. Çështja e sigurisë, lëvizja e lirë e serbëve (dhe e minoriteteve të tjera), si

dhe kthimi i personave të zhvendosur dhe refugjatëve, vazhdon të jetë sfida më e madhe për shtetin e ri të Kosovës. Në afat më të gjatë, kjo pjesë e Ballkanit ka vetëm një rrugëdalje; ajo është integrimi në Bashkimin Evropian, i cili duhet të bëhet *spiritus agens* i bashkëpunimit ndërkulturor dhe ndëretnik si dhe bashkëjetesës paqësore të të gjithë njerëzve.

Bibliografi

- Jakupi, Ali. *Dy shtete shqiptare dhe bashkimi kombëtar*, MMEI, Prishtinë: 2004.
- Kuçi, Hajredin. *Pavarësia e Kosovës*, Jalifat Group, Housto: 2005.
- Lauka, Dr. Islam. *Kosova rast universal apo sui generis?*, Instituti shqiptar për studime politike, Instituti i Historisë i Kosovës, Kristalina-KH, Tiranë: 2007.
- Lipušček, Uroš, Ave Wilson, ZDA, in *Prekrajanje Slovenije v Versaillesu 1919-1920*, Založba Sophia, Ljubljana, 2003.
- Lipušček, Urosh. “Çështja kombëtare Sllovene dhe Shqiptare në kuadrin e Luftës së Parë Botërore - ngjashmëri dhe dallime”, in *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit Shqiptar gjatë shek. XX*, Instituti Historisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë: 2008.
- Malcolm, Noel. *Kosova – Një histori e shkurtër*, Pan Books, London: 2002.
- Pearson, Owen. *Shqipëria dhe mbreti Zog*, Qendra e studimeve shqiptare, London: 2004.
- Pellet, Alain. *Sovraniteti shtetëror dhe mbrojtja e të drejtave themelore njerëzore, një këndvështrim i ligjit ndërkombëtar*. Pugwash Occasional Papers, Shkurt, 2000. [www.pugwash.org/re/pellet.htm](http://www.pugwash.org/reports/re/pellet.htm). Accessed 10/20-2008.
- Silajdžić, Haris, *Albanija i SAD kroz arhive Wašingtona*, Oslobodjenje, Sarajevo: 1991.

Përktheu nga anglishtja Dafina Vezaj.